



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI PORTUAL Durrës**

Data 02.05.2025

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

- “Sigurimi i Pasurisë”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

- Shebim për sigurimin në rast dëmi ose humbje – 66515000-3;
- Shërbime të sigurimit nga zjarri – 66515100-4;
- Shërbime të sigurimit të pronës – 66515200-5;
- Shërbime të sigurimit – 79710000-4.

VLERA E FONDIT LIMIT:

- 25,012,840 (Njëzetë e pesë milion e dymbëdhjetë mijë e tetëqind e dyzet) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3 ;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 10.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, i ndryshuar, si dhe neneve 26 e 30, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

- Sipas referimeve në shtojcën 8 dhe shtojcën 9 të DST-ve.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, i ndryshuar, si dhe në nenin 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të realizuar gjatë tre viteve të fundit financiare (2022-2023-2024), ku vlera e xhiros minimale vjetore, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, të jetë në një me vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të fondit limit, të kontratës që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të LPP, i ndryshuar, në nenin 43, pika 2/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM nr. 922 datë

29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet format elektronikë", si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar. Kërkesat e ligjit nr 25/2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare".

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti Teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbime të mëparshme, të ngjashme, në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Si dëshmi për përvojën e mëparshme Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën që AK kërkon të realizojë, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë kompani sigurimesh e pajisur me licence për ushtrim të aktivitetit për sigurime dhe/ose risigurime nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare, dhe Aneksin bashkelidhur ku të jenë specifikuar qartë klasat për sigurimet e kërkuara në këtë tender.

Operatori ekonomik të ketë në Licensën e ushtrimit të aktivitetit të tij klasat si me poshte:

Klasat 3, 7 dhe 10: Sigurimet motorrike.

Klasa 8: Sigurimi nga zjarri dhe forcat e natyrës (të ndryshme nga ato të përfshira në klasat 3, 4, 5, 6 dhe 7).

Klasa 9: Sigurimi i dëmtimeve të tjera të pasurisë (të ndryshme nga ato të përfshira në klasat 3, 4, 5, 6, 7 dhe 8).

Klasa 10: Sigurimi i përgjegjësi.

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe neneve 41 e 44, të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, si dhe të nenit 28, pika 1 të ligjit 52/2014 “Për veprimtarinë e Sigurimit dhe Risigurimit”.

Licenca për ushtrimin e aktivitetit dhe klasat e kërkuara nga AK janë mbështetur në sigurimin e dëmit që kërkohet në këtë procedurë prokurimi, bazuar në vlerën e lartë të shumave të sigurimit të percaktuara në termat e referencës.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale si dhe klasat perkatese që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente (Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare).

2.3.3 Kontratë risigurimi të vlefshme përgjatë periudhës së zbatimit të kontratës (dokument shoqërues i Risiguruesit, i cili duhet të jetë i klasifikuar në një kategori jo më të ulët se BB+ nga Standard & Poor’s, apo ekuivalente në Fitch Ratings, MOODY’S, AM BEST, për vitin 2023 ose 2024), në të cilën merret përsipër sigurimi i dëmit që kërkohet në këtë procedurë prokurimi.

SQARIM:

Vitet 2023 ose 2024, të vendosura në këtë kriter, i referohen standartit të klasifikimit të Shoqërive Risiguruese në kategorinë jo më të ulët se BBB nga Standard & Poor’s (apo ekuivalente në Fitch Ratings, MOODY’S, AM BEST) dhe jo vlefshmërisë së kontratave risiguruese që, sigurisht, duhet të jenë të vlefshme përgjatë periudhës së zbatimit të kontratës në fjalë.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, nenit 116 të Ligjit nr.52/2014 dhe Rregullores nr. 85/1, datë 30.09.2015, të ndryshuar me nr. 88 datë 27.06.2016, neni 4, pika 1, germa a, “Për kriteret e risigurimit”.

2.3.4 Licencë për vlerësimin e dëmit, lëshuar nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare.

Për përmbushjen e këtij kriteri Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin kopje të noterizuar të “Licencë për vlerësimin e dëmeve materiale dhe shëndetsore” të lëshuar nga AMF, të personave të cilët ushtrojnë veprimtarinë si punonjës të shoqërisë ose vlerësues të pavarur që kanë kontrata bashkëpunimi me to.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, nenit 226, pika 2 dhe neni 227, pika 1, të ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.

Me këtë kriter i kërkohet OE të dëshmojnë se disponojnë vlerësues dëmsh të licencuar sipas legjislacionit në fuqi, për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

Arsyetimi për mos ndarjen e kontratës në lote.

Kontratën e sigurimit të pasurisë nuk e kemi ndarë në lote të veçanta sepse e konsiderojmë këtë shërbim si një paketë të integruar, ku çdo komponent lidhet ngushtë me të tjerët. Për të garantuar një mbulim të qëndrueshëm, efikas dhe pa ndërprerje, është e rëndësishme që sigurimi i aseteve të trajtohen në mënyrë të centralizuar dhe të unifikuar.

Fragmentimi në lote do të sillte rrezik për mbivendosje përgjegjësish, mungesë koherence në zgjidhjen e problemeve dhe vonesa në reagim. Për më tepër, një kontratë e pandarë lejon që të ruhet konsistenca në cilësinë e shërbimit gjatë gjithë periudhës së sigurimit. Ajo mundëson një komunikim të drejtpërdrejtë dhe të qartë mes palëve, si dhe eviton çdo keqkuptim apo vonesë që mund të lindë në rast të koordinimit mes ofruesve të ndryshëm.

Operatorët e huaj ekonomikë duhet të paraqesin të gjithë dokumentacionin e tyre në gjuhën shqip ose anglisht, si dhe në rastin e dokumenteve të lëshuara nga autoritete publike, t’i certifikojnë ato me vulën “Apostille”. Për vendet që nuk e kanë ratifikuar Konventën e Hagës, datë 05.10.1961 për

“Heqjen e kërkesës për legalizim diplomatik e konsullor të dokumentave zyrtare të huaj”, duhet të bëhen legalizimet e ketyre dokumentave në ambasadat, konsullatat ose zyrat respektive nga vendi i origjinës.

➤ **Në fazën e dorëzimit:**

1. Policat e sigurimit duhet të jenë në gjuhën shqipe dhe angleze.
2. Përsa i perket raportimit, në rast ndodhje të ngjarjeve, kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:
 - a. Caktimi i një personi kontakti për komunikim në çdo rast;
 - b. Mënyrën e raportimit në rast ndodhje të dëmit.

➤ **Afati për realizimin e plotë të kontratës së sigurimit të pasurisë së APD-së për vitin 2025 do të jetë brenda 16 (gjashtëmbëdhjetë) muajve dhe do të fillojë nga data e prerjes së polices së parë. Përfundimi i afatit të kontratës së prokurimit do të jetë data e përfundimit të afatit të sigurimit të polices së fundit të prerë, objekt i sigurimit të kësaj kontrate.**

Në dokumentat mbi Termat e Referencës dhe Listat me Objektet që do të Sigurohen, janë përcaktuar, të detajuara të gjitha pikat dhe kriteret e specifikimeve teknike përkatëse, lidhur me objektin e kontratës së prokurimit “Sigurimi i pasurisë”.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.